



*KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.

APLIKIM TARIFOR PËR VITIN 2011

Janar 2011

Përmbajtja:

- 1. Hyrje**
- 2. Përfshirja e Ferronikelit si Konsumatorë i Rregulluar**
- 3. Rregullimin i Nevojshëm Tariforë lidhur me Rritjen e Tantiemës së Linjtit të vendosur nga Qeveria**
- 4. Shqyrtimi i Aplikimit Kryesorë**
- 5. Të Hyrat e Lejuara**
- 6. Tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes**
- 7. Tarifat e Shturura në Bazë të Të Hyrave të Lejuara**
- 8. Zhvillimi i Tarifës Kosto-Reflektuese**
- 9. Dizajni Tariforë**
- 10. Konsultimet**

Tabela Nr. 1, Tarifat Ekzistuese dhe të Propozuara

Tabela Nr. 2, Tarifat Mesatare sipas Grupit – Ekzistuese dhe të Propozuara

1. Hyrje

Duke u bazuar në Udhëzimet për Aplikim Tarifor nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës të aprovuar me 27 Prill 2006, në përputhje me formatin e përfshirë në Shtojcën A.1, KEK Sh.A. e dorëzon këtë Aplikacion në ZRrE për shqyrtimin dhe aprovimin e çmimeve për shërbimin e rregulluar të energjisë elektrike që do të hyjnë në fuqi me 1 Prill 2011.

Me 30 Dhjetor 2010, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) i ka dërguar KEK-ut një letër për përcaktimin e orarit (afatit) për shqyrtimin e tarifave që do të hyjnë në fuqi nga 1 Prilli 2011. Aplikimi Tarifor duhet të dorëzohet në ZRrE me ose par 28 Janarit 2011. KEK-u e dorëzon këtë aplikacion në përputhje me udhëzimet e ZRrE-së.

Ky Aplikacion Tariforë është i përgatitur në formatin elektronikë si dhe i shtypur në letër në përputhje me kushtet që përfshihen në Rregullin për Çmimet, e që lë hapësirë për informacion shtesë nga ZRrE-ja.

Pasi që KEK Sh.A. ka Licensat për Gjenerimin Publikë, Operatorin e Rrjetit të Shpërndarjes dhe Furnizimit Publikë, të gjitha këto kosto janë të përfshira në këtë aplikacion. KEK-u veç i ka përcaktuar tarifat e shturura në përputhje me udhëzimet e ZRrE-së në letrën e datës 30 Dhjetorit 2010:

- *Duke pasur parasysh transaksionin e KEDS-it, në bazë të Ligjeve të reja, mundësinë për kalimin e të gjithë konsumatorëve jo-shtëpiak në kategorinë e konsumatorëve të kualifikuar, tarifat e furnizimit me shumicë të energjisë elektrike, tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes, si dhe tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë duhet të vendosen ndaras. Të licencuarit duhet të sigurojnë që aplikacionet e tyre të përmbajnë propozime përkatëse për secilinë kategori të tarifave dhe të ngarkesave.*

Për të qenë në përputhje me udhëzimet e ZRrE-së për shturjen e tarifave, KEK-u ka përgaditur një analizë të hollësishme duke ndjekur komponentët e tarifave të shitjes me pakicë:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me shumicë
- Shërbimet e Transmisionit
- Tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes sipas nivelit të tensionit.
- Kostot e Furnizimit me Pakicë

Shtojca C është një studim i hollësishëm i bërë nga KEK-u për të zhvilluar tarifat e Përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, duke përdorur analizat e humbjeve teknike dhe komerciale sipas tensionit si dhe Bilancin Energjetik dhe Të Hyrave të Lejuara për vitin 2010 të aprovuara nga ZRrE-ja në procesin e shqyrtimit tariforë për vitin 2010.

Shtojca D është studim i hollësishëm i kryer nga KEK-u për të zhvilluar tarifat e shturura sipas nivelit të tensionit. E përshkruan metodologjinë e përdorur për të analizuar dhe

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

alokuar kostot, duke përdorur Bilancin Energjetik për vitin 2010 dhe Të Hyrat e Lejuara të aprovuara nga ZRrE-ja në procesin e shqyrtimit tarifor për vitin 2010.

Metodologjia dhe alokimet e njëjta janë përdorur për të zhvilluar tarifatat e shthurura duke përdorur Bilancin Energjetik dhe Të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 të propozuara nga KEK-u në këtë aplikacion.

Para se të përcaktohen Të Hyrat e Lejuara dhe tarifatat për vitin 2011, janë dy çështje të cilat duhet të adresohen dhe të zgjidhen:

- I. Me 6 Dhjetor 2010, KEK-u e ka dorëzuar një aplikacion për tu shqyrtuar dhe aprovuar nga ZRrE-ja tarifatat e rregulluara për konsumatorët të kyçur në nivelin e tensionit 220 kV. Siç shpjegohet në aplikacion, posa të skadojë kontrata me Ferronikelin, KEK-u do i shërbej Ferronikelit vetëm përmes licencës së Furnizuesit Publik si konsumatorë i rregulluar. Si mundësi alternative, Ferronikeli është i lirë të përdorë statusin e tij të konsumatorit të privilegjuar për të blerë energji jashtë Kosovës. Bilanci energjetik është përgatitur nën supozimin se ky konsumatorë do të vendos të bëhet një konsumator i rregulluar. Nëse nuk ndodhë kështu, i tërë bilanci energjetikë duhet të korrigjohet. Përveç kësaj, tarifatat e propozuara këtu janë të bazuara nën supozimin se ZRrE-ja do të aprovoj përbërjen e kërkuar të tarifës 220 kV me 4.2 € për kWh që kërkohet në aplikacion. Çdo tarifë nën atë nivel do të kërkonte edhe rritjen e tarifave të konsumatorëve tjerë për të mbuluar mungesën. Përveç kësaj, nëse Ferronikeli nuk do të shërbehet në tarifën e rregulluar, mekanizmi i tarifës së rritur për rritjen e Tantiemës së Linjtit (e diskutuar në pikën II më poshtë) duhet të rregullohet ashtu që konsumatorët tjerë të bartin të gjitha kostot. Luteni të shikoni Seksionin 2 për shqyrtimin e kësaj çështje.
- II. Me 13 Tetor 2010, KEK-u ka dorëzuar “Aplikacion për Rregullimin e një Çështje të Vetme Tarifore” për shqyrtim dhe aprovim nga ZRrE-ja të një rregullimi tariforë për t’ia mundësuar KEK-ut të mbulojë rritjen e dukshme të kostos që pritet të vendoset nga Qeveria për tantiemën e linjtit. Në kohën kur është dorëzuar ky Aplikacion, supozohej që tantiema e rritur do të hyjë në fuqi para 1 Prillit 2011, megjithatë tani pritet që tantiema e rritur do të hyjë në fuqi deri me 1 Prill 2011. KEK-u e ka informuar Qeverinë se nuk do të paguaj ndonjë rritje të tantiemës përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë që kostoja të trajtohet përmes tarifave të shitje me pakicë. KEK-u kërkon nga ZRrE-ja që të rrisë në mënyrë të veçantë komponentin e energjisë për secilën tarifë të rregulluar siç diskutohet në Seksionin 3 të këtij aplikacioni. Kjo çështje e vetme nuk duhet të përzihet me çështjet tjera tarifore në këtë aplikacion që ka të bëjë me Të Hyrat e Lejuara për vitin 2011.

2. Përfshirja e Ferronikelit si Konsumatorë i Rregulluar

Me 6 Dhjetorë 2010 KEK-u ka dorëzuar në ZRrE aplikacionin për shqyrtimin dhe aprovimin e tarifave të rregulluara për konsumatorët të kyçur në nivelin e tensionit 220 kV. Siç shpjegohet në aplikacion, posa të ketë skaduar kontrata me Ferronikelin, KEK-u do i shërbej Ferronikelit vetëm nën licencën e Furnizuesit Publikë si konsumator i rregulluar. Si alternativë, Ferronikeli është i lirë të përdorë statusin e tij të konsumatorit të privilegjuar (Kualifikuar) për të blerë energji jashtë Kosovës. Bilanci energjetik është përgatitur nën supozimin se ky konsumatorë do të vendos të bëhet një konsumator i rregulluar. KEK-u pret vendimin e ZRrE-së në këtë çështje të rëndësishme.

Që nga data e dorëzimit të këtij aplikacioni, KEK-u nuk ka pasur ndonjë komunikim me ZRrE-në për të treguar se ka ndonjë kundërshtim ndajë tarifës së rekomanduar. Kështu që, KEK-u vazhdon me supozimin se Ferronikli do të bëhet konsumator i rregulluar në Prill 2011 me ngarkesën e supozuar në Bilancin Energjetikë të vitit 2011 (90 MW Fuqi dhe 678,287 MWh të konsumit) dhe tarifat e rregulluara në vijim:

| | |
|-----------------------------------|--|
| Ngarkesa fikse | 1,000 Euro në Muaj |
| Ngarkesa për Fuqinë e kontraktuar | 13.00 €/ kW për Fuqinë e kontraktuar për muaj |
| Pagesa mujore e energjisë | 2.09 € për të gjithë kWh |
| Ngarkesa shtesë | 26.00 €për kW për secilin kW shtesë të fuqisë së Kontraktuar në çdo Muaj |

Pagesa për energjinë e cekur më lartë është ekskluzive për plotësimin e pritur të energjisë 0.57€/kWh e shqyrtuar në Seksionin 3 të këtij aplikacioni.

3. Rregullimi Tariforë që Kërkohet për Rritjen e Tantiemës së Linjtit të Caktuar nga Qeveria

Me 13 Tetor 2010, KEK-u ka dorëzuar “Aplikacion për Rregullimin e një Çështje të Vetme Tarifore” për shqyrtim dhe aprovim nga ZRrE-ja të një rregullimi tariforë për t’ia mundësuar KEK-ut të mbulojë rritjen e dukshme të kostos që pritet të vendoset nga Qeveria për tantiemën e linjtit. Siç është cekur në aplikacionin e 23 Shtatorit 2010, KEK-u ka pranuar një letër nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale që tregon se, “në përputhje me legjislacionin dhe kompetencat e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), pas një konsultimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, në takimin e mbajtur me datën 27.08.2010 KPMM morri vendim për të përcaktuar tarifat e reja lidhur me rritjen e tantiemës së linjtit”.

Siç është shqyrtuar në atë aplikacion, tarifat me pakicë të cilat tani janë në fuqi përfshijnë €2.2 milion në Të Hyrat e Lejuara për tantiemën e linjtit. Tantiema e re e aprovuar do të rezultojë në një shpenzim të përgjithshëm vjetorë për tantiemën në €22.5 milion, kështu që e bënë të nevojshme një rritje prej €20.3 milion të Të Hyrave të Lejuara. Në kohën kur është dorëzuar aplikacioni i datës 13 Tetor, supozohej që tantiema e rritur do të hyjë në fuqi para 1 Prillit 2011, megjithatë tani pritet që tantiema e rritur nuk do të hyjë në fuqi deri me 1 Prill 2011. Llogaritja që ka bërë KEK-u për pagesën e rritur të energjisë ishte bazuar në Bilancin Energjetik 2010 që supozonte Ferronikelin si konsumator të pa rregulluar. Kjo ngritje e pagesës për energji duhet të korrigjohet për të përfshirë informatat e vitit 2011. Në bazë të kësaj llogaritje të korrigjuar të pagesës së rritur të energjisë lidhur me çështjen e tantiemës së linjtit:

| | |
|--|-------------------------|
| Tantiema e Linjtit që pritet të hyjë në fuqi në Prill 2011 | €2.79 për ton thëngjill |
| Thëngjilli i përdorur nga Gjenerimi i KEK-ut sipas bilancit energjetik | 7,536,359 ton |
| Kostot e Pritura të Tantiemës | €21,026,442 |
| Kosto e tantiemës e përfshirë në tarifat e tanishme | €2,184,000 |
| Rritja e shpenzimeve në tantiemën e thëngjillit | €18,842,442 |
| Energjia e faturuar sipas Bilancit Energjetik 2011 | 3,481,016,000 kWh |
| Rritja e nevojshme në pagesat e shitjes me pakicë | 0.541 € për kWh |

KEK-u e ka informuar Qeverinë se nuk do të paguaj ndonjë rritje të tantiemës përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë që kostoja të trajtohet përmes tarifave të shitjes me pakicë. KEK-u kërkon nga ZRrE-ja që ta rrisë në mënyrë të veçantë komponentin e energjisë për secilën tarifë të rregulluar siç shqyrtohet në Seksionin 3 të këtij aplikacioni. Kjo çështje e vetme nuk duhet të përzihet me çështjet tjera tarifore në këtë aplikacion që ka të bëjë me Të Hyrat e Lejuara për vitin 2011.

Në vendimin e saj lidhur me tarifat në fuqi që nga 1 Prilli 2010, ZRrE-ja ka vendosur që tarifa mesatare e shitjes me pakicë të jetë 5.30 € për kWh.¹ Pasi që rritja është 0.541 €

¹ Letra Konsultative e ZRrE-së e dates 26 Shkurt 2010, Faqe 10

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

për kWh, rritja do të jetë 10.2%. Ekzistojnë përafërsisht 4,000 konsumatorë në tarifën e pa-maturë (paushallë). KEK-u propozon që të rritet tarifa paushallë për ata konsumator me 10.2%, mesatarja e rritjes së përgjithshme në tarifatat me pakicë për shkak të rritjes së taniemës.

Tabela në vijim përmban tarifatat e propozuara që të hyjnë në fuqi menjëherë pas aprovimit nga ZRrE-ja, në krahasim me tarifatat e tanishme. Siç u diskutua më lartë, të gjitha pagesat për kWh të energjisë ishin rritur me €0.0054 dhe tarifatat e pamatura ishin rritur me 10.2% (dhe rrumbullakësuar).

Pagesa e propozuar e energjisë për Ferronikelin (2.09 € për kWh) poashtu duhet të rritet me 0.54 €, që rezulton në një çmim të korrigjuar prej 2.63 € për kWh.

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Ndryshimet e Propozuara në Tarifat Ekzistuese për Rritjen e Tantiemës së Linjitet

| Grupi Tarifor | Niveli i Tensionit të Furnizimit | Elementet Tarifore | Njësia | Koha e Përdorimit | Tarifat Ekzistuese | | Propozuar - KEK | |
|---------------|--|--|-------------------|-------------------|---|--|---|--|
| | | | | | Sezoni i Lartë 1 Tetorë - 31 Mars | Sezoni i Ulët 1 Prill - 30 Shtator | Sezoni i Lartë 1 Tetorë - 31 Mars | Sezoni i Ulët 1 Prill - 30 Shtator |
| 0 | 110kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 83.83 | | 83.83 | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 5.59 | 5.59 | 5.59 | 5.59 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | 6.49 | 1.92 | 7.03 | 2.46 |
| | | Energjia Reaktive | €/kVArh | Tarifa e Ulët | 2.70 | 1.58 | 3.24 | 2.12 |
| 1 | 35kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 11.08 | | 11.08 | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 5.81 | 5.81 | 5.81 | 5.81 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | 6.79 | 2.94 | 7.33 | 3.48 |
| | | Energjia Reaktive | €/kVArh | Tarifa e Ulët | 3.59 | 2.65 | 4.13 | 3.19 |
| 2 | 10kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 4.58 | | 4.58 | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 5.01 | 5.01 | 5.01 | 5.01 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | 7.61 | 3.39 | 8.15 | 3.93 |
| | | Energjia Reaktive | €/kVArh | Tarifa e Ulët | 4.10 | 3.09 | 4.64 | 3.63 |
| 3 | 0.4kV Kategoria I (Konsumatorët e mëdha me Energji Reaktive | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.58 | | 2.58 | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 2.91 | 2.91 | 2.91 | 2.91 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | 8.45 | 4.69 | 8.99 | 5.23 |
| | | Energjia Reaktive | €/kVArh | Tarifa e Ulët | 5.33 | 4.43 | 5.87 | 4.97 |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.92 | | 2.92 | |
| | | Active energy (P) | €/kWh | Një Tarifor | 10.41 | 6.73 | 10.95 | 7.27 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | 12.53 | 8.21 | 13.07 | 8.75 |
| | | Energjia Reaktive | €/kVArh | Tarifa e Ulët | 6.26 | 4.10 | 6.80 | 4.64 |
| 5 | 0.4kV (Shtëpiak, 2-Tarifor) | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.08 | | 2.08 | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: <200kWh/month (First Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | 4.64 | 3.33 | 5.18 | 3.87 |
| | | | €/kWh | Tarifa e Ulët | 2.33 | 1.66 | 2.87 | 2.20 |
| | | 200-600 kWh/month (Second Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | 6.43 | 4.60 | 6.97 | 5.14 |
| | | | €/kWh | Tarifa e Ulët | 3.22 | 2.31 | 3.76 | 2.85 |
| | | >600 kWh/month (Third Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | 9.33 | 6.68 | 9.87 | 7.22 |
| | | | €/kWh | Tarifa e Ulët | 4.66 | 3.35 | 5.20 | 3.89 |
| | | | | | | | | |
| 6 | 0.4kV (Shtëpiak, 1-Tarifor) | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.08 | | 2.08 | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: <200kWh/month (First Block): | €/kWh | Një Tarifor | 4.14 | 2.96 | 4.68 | 3.50 |
| | | 200-600 kWh/month (Second Block): | €/kWh | Një Tarifor | 5.73 | 4.10 | 6.27 | 4.64 |
| | | >600 kWh/month (Third Block): | €/kWh | Një Tarifor | 8.31 | 5.96 | 8.85 | 6.50 |
| 7 | 0.4kV (Shtëpiak i Pa matur) | Konsumi i përfaqësuar <200kWh/muaj | €/customer/month | | 21.50 | | 23.60 | |
| | | Konsumi i përfaqësuar 200-600kWh/muaj | €/customer/month | | 38.92 | | 42.70 | |
| | | Konsumi i përfaqësuar >600kWh/muaj | €/customer/month | | 65.58 | | 71.95 | |
| 8 | Ndriqimi Publik | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.92 | | 2.92 | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: | €/kWh | Një Tarifor | 8.42 | 8.42 | 8.96 | 8.96 |

Tarifat e Propozuara janë të barabarta me Tarifat Ekzistuese + 0,54€/kWh shtesë për të gjitha ngarkesat e energjisë aktive.

Tarifat për konsumatorët në kategorinë e Pa-matur (Paushall) janë ngritur për 9,7%.

4. Shqyrtimi i Aplikacionit Kryesorë

Pikat kryesore të aplikacionit përfshijnë:

- KEK-ua i ka përdorur parimet e përcaktuara nga ZRrE-ia në vendimet e mëparshme tarifore, përfshirë edhe çështjet e dizajnit tariforë në vijmë:
 - Tarifat individuale duhet të lëvizin më afër kostove për t'i shërbyer konsumatorëve përkatës. Në bazë të kësaj, amvisëria përbën përafërsisht 55% të ngarkesës së rregulluar dhe është dukshëm më ulët se kostoja, ato tarifa duhet të ngritën më shumë sesa ngritja e përqindjes mesatare në mënyrë që të afrohen më afër tarifave kosto-reflektuese. Komponentët e tarifës së shturur do të përdorën si udhëzim për të matur sa kosto-reflektuese janë tarifrat individuale.
 - Nuk ka ndryshim të dukshme përveç në tarifrat ekzistuese. Shih seksionin 9 për shqyrtimin e çështjeve të strukturës tarifore.
 - Caktimi i çmimit për kohën e përdorimit (periudhat e larta dhe të ulëta) do të vazhdojnë, edhe pse KEK-u nuk është i pajtimit se është efektive në aspektin e çmimit për konsumatorët e amvisërisë pasi që ata janë të kufizuar në mundësinë e bartjes së ngarkesës.
 - Bllok struktura ekzistuese për amvisërinë do të vazhdojë edhe pse KEK-u nuk është i pajtimit se blloku i parë është një mënyrë efektive për ta adresuar çështjen e varfërisë në Kosovë.

4.1 Parashikimi i Planifikuar i Ngarkesës (Bilanci Energjetikë)

Energjia në dispozicion (Gjenerimi i KEK-ut, blerja nga hidro-gjenerimi, importi dhe eksporti), humbjet në sistemet e transmisionit dhe shpërndarjes dhe shitjet te konsumatorët që janë përdorur në këtë Aplikacion janë ato që përfshihen në Bilancin Energjetik përfundimtarë të Aprovuar nga ZRrE-ja në Nëntor 2010 dhe e përmbledhur në tabelën në vijim:

Parashikimi Energjetik 2011

(GWh)

| | | |
|---|--------------|--------------|
| Gjenerimi i KEK-ut | 4,768 | |
| Blerja e energjisë nga Hidrocentralet | 125 | |
| Importet | 893 | |
| Eksportet | (194) | |
| Humbjet në transmission (2.5% e rrjedhës së energjisë) | (172) | |
| Konsumi i Brendshëm (mihja primare) | (126) | |
| Humbjet teknike në Shpërndarje (17.5% e energjis së futur në Shpërndarje) | (797) | |
| Humbjet Jo-Teknike në Shpërndarje (20% e energjis së futur në Shpërndarje) | (825) | |
| Energjia e pafaturuar e Liferuar në Veri | (189) | |
| Deficiti në Furnizim | (2) | |
| SHITJET TE KONSUMATORËT | | 3,481 |
| <u>ALOKIMI I SHITJEVE</u> | | |
| Transmisioni (220 & 110 KV) | 768 | |
| Konsumatorët e Shpërndarjes | <u>2,713</u> | |
| SHITJET E PËRGJITHSHME | | 3,481 |

- Shitjet e paralogaritura (përafërsisht) te konsumatorët e rregulluar me 3,481 GWh përfshinë shitjet te konsumatorët e shpërndarjes me 2,713 GWh dhe shitjet te konsumatorët në nivelin e transmisionit me 768 GWh, që përfshinë Ferronikelin si konsumatorë të rregulluar.
- Shitjet e paralogaritura përjashtojnë shitjet te konsumatorët në pjesën veriore të Lumit Ibër, pasi që tani për tani KEK-u nuk ka pranuar asnjë informatë nga Komuniteti Ndërkombëtar se a mund të vazhdoj me rregullimin e atyre konsumatorëve në Veri të Kosovës. Pasi që vendimi se kur mundet KEK-u të rregullojë veprimtarinë në pjesën veriore të lumit Ibër është krejtësisht jashtë kontrollit të KEK-ut dhe varet nga organizatat ndërkombëtare, bilanci energjetikë tregon se energjia e dhënë në pjesën Veriore të Kosovës (e llogaritur përafërsisht 189 GWh në 2011) është një “Humbje Politike” siç ka qenë gjatë dhjetë viteve të fundit.
- Humbjet Komerciale, të definuara nga ZRRë-ja si ndryshimi mes (1) energjisë në dispozicion për Shpërndarje (pas rregullimit të humbjeve teknike prej 17.6%, humbjeve politike prej 4.2%, dhe përdorimit të brendshëm) dhe (2) energjisë së faturuar, është 18 %. Ky është një zvogëlim nga niveli 20% i lejuar në tarifat e

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

aprovuar për vitin 2010 dhe tregon se KEK-u po bënë përpjekje për zvogëlimin e humbjeve.

KEK-u ka alokuar komponentët e shitjes së energjisë për vitin 2011 nëpër klasat e konsumatorëve duke përdorur të dhënat bazë të vitit 2010 sipas klasave të konsumatorëve si në vijim:

- Numri i Konsumatorëve
- Fuqia (kW) për ato klasa me njehsorë të ngarkesës
- Energjia Aktive (kWh) sipas kohës së përdorimit ditore dhe stinës
- Energjia reaktive për klasat adekuate

Rezultati është “Përcaktuesit e Faturimit” të përfshirë në Shtojcën B. Kjo ia mundëson ZRrE-së që të analizojë ndikimin e shitjeve të paralogaritura për 2011 në secilën klasë tarifore, të hyrat që do të rezultojnë nëse tarifat ekzistuese do të ishin në funksion për tërë vitin 2011 dhe përfundimisht në mundësin e dizajnit të tarifave për vitin 2011 për të mbuluar Të Hyrat e Lejuara të aprovuara përfundimisht.

5. Të Hyrat e Lejuara

Në shtojcën A të këtij aplikacioni KEK-u dorëzon llogaritjen e të hyrave të lejuara bazuar në Modelin Tariforë të KEK-ut që përfshinë:

- Bilancin Energjetikë,
- Koston e Energjisë së Blerë,
- Kostot e Mihjes,
- Kostot e Gjenerimit,
- Kostot e Shpërndarjes,
- Kostot e Furnizimit, dhe
- Kostot e Administratës (Drejtorisë) Qendrore.

Ne po ashtu i dorëzojmë të dhënat e kërkuara nga ZRrE-ja për modelin e tyre tariforë.

Ky seksion i jep rezultatet për kërkesën e kostove të lejuara që kërkohen nga divizionet e KEK-ut: Mihja, Gjenerimi, Rrjeti dhe Furnizimi, plus kostot për Administratën Qendrore të KEK-ut, që janë alokuar në secilin nga divizionet bazuar në numrin punëtorëve në pajtueshmëri me praktikën e ZRrE-së. Të Hyrat e Lejuara janë llogaritur dhe janë futur në Modelin Tariforë që rezulton në shumën prej €197.7 milion.

Llogaritja e Të Hyrave të Lejuara për Divizionet e KEK Sh.A. është bërë në bazë të Metodologjisë Tarifore të ZRrE-së dhe Modelit Tariforë të KEK-ut (Model i datës: 28 Janar 2011). Shuma e të hyrave që është llogaritur në bazë të të dhënave energjetike dhe financiare do t'ia mundësojë Furnizuesit Publikë që të mbulojë Të Hyrat e Lejuara nga tarifën e pakicës që i ngarkohen konsumatorëve të rregulluar për furnizimin me energji elektrike. Theksimet e komponentëve të Të Hyrave të Lejuara që janë kërkuar, përfshijnë:

- Kërkesën për të Hyrat e Lejuara në shumën prej €197.7 milion. Kjo përfshinë kostot që lidhen me shërbimin dhënë Feronikelit (që nuk është konsumatorë i rregulluar në vitin e parë) por përjashton tantumën e rritur të linjitet që është kualifikuar dhe alokuar në klasat tarifore. Të hyrat e lejuara të kërkuar përfshijnë ndikimin e shpenzimeve kapitale për mihje dhe gjenerim për të siguruar thëngjillin e nevojshëm dhe për të vazhduar furnizimin me energji për konsumatorët në nivel të përmirësuar që janë provuar në dy vitet e kaluara.
- Ngritja e pritur në tantumën e linjitet NUK është përfshirë në Të Hyrat e Lejuara. KEK-u pret që ZRrE-ja ta vlerësojë veçmas këtë pagesë (taksë) të re dhe t'ia lejojë KEK-ut të mbulojë koston e rritur duke e ngritur pagesën e energjisë në secilën tarifë me 0.54 € për kWh siç është diskutuar në Seksion 3.
- Sasia bazë e importuar është 893 GWh në pajtueshmëri me bilancin energjetikë. Kostoja është vlerësuar të jetë €3.3 milion (€60 për MWh) në 2011 bazuar në çmimet e kontratës për çerekun e parë të vitit 2011 dhe një vlerësim të koston për pjesën tjetër të vitit bazuar në ofertat e pranuar së fundmi. Në mënyrë që të ofrohet shërbim i qendrueshëm për konsumatorët që paguajnë, buxheti për blerjen e energjisë elektrike po ashtu përfshinë një lejim minimal për import emergjent gjatë rënies së papritur të blloqeve të gjenerimit, në kosto prej €1.7 milion. Kjo nxjerrë një kosto të përgjithshme për energjinë e importuar në vlerë €55 milion. Kjo është

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

pikënisje nga Subvencioni për Energjinë e Importuar prej €35 milion që përfshihet në Projekt Buxhetin Preliminar të Kosovës për vitin 2011.

- Eksporti në vlerë prej €4.4 milion
- Ngarkesa e parallogaritur e KOSTT-it prej €19.8 milion për Gjenerimin e KEK-ut dhe Furnizimin e KEK-ut.
- Të Hyrat e Lejuara të kërkuara përfshijnë edhe shpenzimet e lejuara për Borxhin e Keq prej €5 milion që barazohet me 2.5% të Të Hyrave të Lejuara për vitin 2011 ose 25% e të hyrave aktuale të alokuara për vitin 2010. Të dy shumat janë shumë më të ulëta se niveli historik ose i planifikuar. Çdo biznes i cili nuk kërkon pagesën me ose para dorëzimit të produktit shkakton shpenzimin e borxhit të keq, bile edhe tek kompanit me efikasitet të lartë komercial. Derisa KEK-u përmirëson normën e inkasimit deri në nivelin e pranueshëm, do të donte të trajtohet në një mënyrë më të orientuar komercialist dhe për të reduktuar barrën në BKK duke përfshirë këtë lejim të borxhit të keq në tarifatat me pakicë.
- Një kapital punues prej €10 milion që paraqet përafërsisht për 25 ditë të shpenzimeve operative. Shumica e ndërmarrjeve kanë më shumë se 45 ditë lejime për mungesën mes kostove kur janë shkaktuar shpenzimet dhe inkasimet. Kërkesa e KEK-ut është mjaftë konservative.
- Të Hyrat e Lejuara të kërkuara e përjashtojnë zhvlerësimin dhe kthimin e aseteve para 2006 siç e ka autorizuar ZRrE-ja në të kaluarën. KEK-u beson se ato elemente të kostos duhet të përfshihen në tarifatat me pakicë në pajtueshmëri me Ligjin e ri për Rregullatorin e Energjisë. Seksioni 5.2 përmban një shqyrtim të kësaj çështje dhe jep informata në madhësinë e zhvlerësimit dhe kthimit në asetet para vitit 2006.
- Zhvlerësimi dhe Kthimi i llogaritjes së investimeve për vitin 2011 reflekton atë që pritet nën shpenzimet e vitit 2010 me përafërsisht €50 milion siç paraqitet në modelin tarifor. Kthimi në investime ishte llogaritur duke përdorur normat e aprovuara të ZRrE-së prej 13.1%, në të cilën janë bazuar tarifatat e tanishme.

Kërkesa për të Hyrat e Lejuara është e bazuar në vitin testues 2011. Viti testues 2011 është përdorur sepse tarifatat përfundimtare të aprovuara nga ZRrE-ja në këtë aplikim, pritët të hyjnë në fuqi me 1 Prill 2011. Të gjitha të dhënat në Modelin Tariforë (Balanci Energjetikë, Kostot, etj.) janë të bazuara në vitin kalendarik 2011. Së bashku me këtë Aplikacion, KEK i jep ZRrE-së rezultatet e modelit tarifor, përfshirë hollësitë e secilit komponent. ZRrE-së i është dhënë modeli, dokumentet e modelit (Manuali) dhe prezantimi i modelit të aplikimit të fundit tariforë. KEK-u po ashtu jep hollësitë e llogaritjes në metodologjinë për tarifatat e Përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes dhe kostot e shthurura për komponentët e Shitjes së Energjisë me Shumicë, Transmetimit dhe Furnizimit. Shih Shtojcën C dhe D.

5.1. Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OpEx)

Në shqyrtimin e aplikim të fundit tariforë, ZRRë-ja i ka aprovuar shpenzimet operative dhe ato të mirëmbajtjes (OpEx), për KEK-un në vlerë përafërsisht €11 milion (duke përfshirë drejtorinë qendrore). Kjo është përcaktuar të jetë shuma e nevojshme për t'ju ofruar konsumatorëve një nivel të arsyeshëm të shërbimit. Është përfshirë një lejueshmëri prej €3 milion për shpenzimet që kanë të bëjnë me shërbimin në pjesën Veriore të Kosovës nën supozimin se komuniteti ndërkombëtar do të pajtohet që ta lejojë KEK-un që të rregullojë ata konsumatorë dhe të fillojnë faturimin e tyre. Tani për tani, nuk pritet ndonjë vendimi i shpejt nga komuniteti ndërkombëtarë dhe bilanci energjetik tregon se nuk do të ketë shitje në atë pjesë. Për qëllim të këtij aplikacioni tariforë, KEK-u propozon të përdorë shpenzimet e aprovuara të OpEx-it të përfshira në tarifën e tanishme pa (minus) €3 milion lidhur me pjesën Veriore, në një shumë neto që është përafërsisht €108 milion.

Buxheti i OpEx-it për vitin 2011 i aprovuar nga Bordi i drejtorëve është përafërsisht €104 milion. Kjo shumë përfshinë vetëm shpenzimet me prioritet të lartë për vitin 2011 të bazuara në kufizimin e parave të gatshme dhe duke mos supozuar asnjë rritje tarifore gjatë vitit (përveç kalimit potencial përmes tantumës së linjës). Departamentet kërkuan shuma dukshëm më të larta por se Bordi ishte përqendruar në buxhetin e bilancit të parasë së gatshme. Situata financiare do të shqyrtohet derisa kalon viti. Në rast se inkasimi përmirësohet, mund të lejohet një rritje e nivelit të OpEx-it nga ana e Bordit.

Llogaritë financiare të vitit 2010 akoma nuk janë mbyllur dhe rezultatet aktuale për vitin nuk do të jenë të gatshme të paktën deri në fund të çerekut të parë të vitit. Faturat janë akoma në proces e sipër, inventarët janë duke u barazuar dhe po bëjnë barazimet e nevojshme. Bazuar në përkufizimet financiare gjatë vitit 2010, duke përfshirë faktin se nuk ka pasur ngritje tarifore, menaxhmentit i është kërkuar që të kufizojë shpenzimet e OpEx-it për shkak të kufizimeve në paratë e gatshme. Në pajtim me të dhënat e kërkuara nga ZRRë-ja, KEK-u ofron një parallogaritje shumë preliminare për shpenzimet e OpEx-it për vitin 2010 që është përafërsisht €9 milion. Kjo është përafërsisht 8% më ulët se sa vlera e aprovuar nga ZRRë-ja për vitin 2010 (duke përfshirë shpenzimet që kanë të bëjnë me pjesën Veriore).

5.2. Kostot Kapitale Lidhur me Asetet par vitit 2006

Metodologjia Tarifore, e zhvilluar në vitin 2006 e ka specifikuar trajtimin e kostove të përfshira në asetet fikse të ndërtuara para vitit 2006. Në Seksionin 4.2.1, metodologjia tregon:

Pranimi i kësaj si dhe qasjet e ndryshme për financimin e këtyre asetëve, kjo metodologji tarifore poashtu e parasheh një dallim mes trajtimit të kthimit të kostove kapitale të shoqëruara me asetet e ndërtuara gjatë ose para vitit 2005 the ato të ndërtuara pas kësaj date.

Metodologjia e specifikon përjashtimin e kësaj vlere për asetet fikse që janë marrë para vitit 2006 nga kthimi i kostove në formën e zhvlerësimit dhe kthimit për arsyet që mund të justifikohen vetëm në kuptimin ekonomik si një mënyrë për të mbajtur tarifën nën kosto në mënyrë artificiale.

Me 7 tetor 2010 është miratuar, **LIGJI Nr. 03/L –185 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË** dhe ekzistojnë dy seksione të atij ligji që janë shumë relevante për këtë diskutim si në vijim:

Neni 42, Metodologjia Tarifore

“3. përveç parimeve të reflektimit të kostos të përcaktuar në Nenin 40, çdo metodologji tarifore do të bazohet në parimet në vijim:

3.3. Tarifat përkitazi me sistemet e transmisionit dhe shpërndarjes janë adekuate në mënyrë që të mundësojnë investimet e domosdoshme në sistemet që do të kryhen ashtu që t'i lejojë këto investime që të sigurojnë zbatueshmërinë e sistemeve”

Neni 43, Aprovimi i Tarifave

“3. Në aprovimin e tarifave fikse, Zyra e Rregullatorit për energjisë do të sigurojë që të licencuarit të lejohen të mbulojnë të gjitha kostot e arsyeshme, duke përfshirë:

3.6. Kostot normale të zhvleftësimit mbi të gjitha asetet e përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara, dhe “ Baza e Aseteve të Rregulluara” nënkupton të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvleftësuar”.

Ligji i ri e njeh (pranon) se në mënyrë që të mbetet i zbatueshëm, një ndërmarrje e rregulluar duhet të mbulojë koston e asetëve fikse. Në rastin e Kosovës, kjo duhet të përfshijë asetet para vitit 2006, në të cilat natyrisht përfshihen centralet e gjenerimit të Kosovës A dhe B si dhe shumica e infrastrukturës së shpërndarjes. Me sa ka kuptuar KEK-u, legjislacioni sekondar, siç është Metodologjia Tarifore, do të korrektohet gjatë vitit 2011 për të eliminuar kundërshtimet me ligjin e ri primar. Për këtë arsye, KEK-u po i jep informacionet në vijim për Të Hyrat e Lejuar për Vitin 2011, sikur të ishte i përfshirë edhe zhvlerësimi dhe kthimi i asetëve para vitit 2006.

Pasqyrat Financiare të Audituarra për vitin 2006 janë përdorur si bazë për përcaktimin e shumës adekuate të zhvlerësimit dhe kthimit që do të duhej të shtohet në të hyrat e lejuara për të përfshirë asetet para vitit 2006. Tabela në vijim paraqet informatat nga pasqyrat e audituarra që përfshijnë transferimin e asetëve të transmisionit të KOSTT-i gjatë vitit 2006.

| Të Dhënat nga Pasqyrat e Audituarra Financare 2006 | |
|---|-----------|
| (Të gjitha Shumat në Mijë Euro) | |
| Prona, Centralet, dhe Pajisjet me 31 Dhjetor 2005 | |
| Kostoja Fillestare | 506,073 |
| Imperamenti i Akumuluar | (163,316) |
| Kostoja Neto | 342,757 |
| Transferimi Aseteve të Transmisionit në 2006 | 23,022 |
| Kostoja Neto pas Transferimit | 319,735 |
| Zhvlerësimi i Akumuluar me 31 Dhjetor 2005 | 107,303 |

Të dhënat në tabelën më poshtë janë nxjerrë nga të dhënat bazë. Janë bazuar në një përbërje prej 7% të normës së zhvlerësimit në vit (përafërsisht normat e përdorur për qëllim të raportimit financiar) dhe një kthim në investim prej 13.1% në vit, vlera e përdorur nga ZRrE-ja në procesin tariforë 2010 .

(Mija Euro)

| Llogaritja e Zhvlerësimit dhe Kthimit në Asetet par vitit 2006 | |
|---|---------------|
| Vlera Neto e Aseteve me 01 Janar 2006 | 319,735 |
| Zhvlerësimi Vjetorë 2006 - 2010 (7%/vit) | 111,907 |
| Zhvlerësimi i Akumuluar me 1 Jan 2006 | 219,210 |
| Asetet e Zhvlersuara Neto me 1 Janar 2011 | 100,525 |
| Zhvlerësimi për vitin 2011 me 7% | 22,381 |
| Asetet e Zhvlersuara Neto me 31 Dhjetor 2011 | 78,143 |
| Baza Mesatre e Aseteve të Rregulluar për 2011 | 89,334 |
| Norma e Kthimit | 13.1% |
| Kthimi në Investim | 11,703 |

Lexuesi mund të shohë se zhvlerësimi i përfshirë në Të Hyrat e Lejuara do të jetë më i lartë për €2.4 milion dhe kthimi më i lartë për €1.7 milion për një rritje të përgjithshme prej €4.1 milion në të Hyrat e Lejuara. Sikur KEK-u të kishte përfshirë këtë shumë në Të Hyrat e Lejuara që i ka kërkuar, ato do të ishin 17% më të larta, që nënkupton një rritje

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

tarifore shtesë prej 17%. KEK-u e kupton se një ngritje e tillë duhet të bëhet gradualisht me kohën.

KEK-u poashtu i ka alokuar këto vlera në katër njësitë operative (Mihje , Gjenerim, Rrjetë, dhe Furnizim) dhe do t'ia japë këtë informatë ZRrE-së .

Përmbledhje e Të Hyrave të Lejuara - 2011

TË HYRAT E LEJUARA BAZUAR NË PARASHIKIMIN E 2011

Shqip English

| Line No. | Përshkrimi | Mihjet | Gjenerimi | Rrjeti | Furnizimi | Total KEK |
|----------|---|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-------------------|
| 1 | Shpenzimet Operative | 42.244,0 | 30.801,8 | 16.714,0 | 9.103,3 | 98.863,1 |
| 2 | Zhvlerësimi | 8.898,8 | 4.911,7 | 1.142,9 | 438,9 | 15.392,3 |
| 3 | Kthimi | 22.152,5 | 6.663,4 | 3.307,9 | 1.420,7 | 33.544,4 |
| 4 | Margjina e Furnizimit | | | | 5.359,0 | 5.359,0 |
| 5 | Importi | | | | 55.000,0 | 55.000,0 |
| 6 | Subvencionet për Import | | | | -35.000,0 | -35.000,0 |
| 7 | Blerjet në Nivel të Distribucionit | | | | 3.971,0 | 3.971,0 |
| 8 | Obligimi ndaj KOSTT-it | | 4.538,9 | | 15.215,7 | 19.754,6 |
| 9 | Shitjet e Energjisë te KOSTT për Humbje | | | | -5.806,0 | -5.806,0 |
| 10 | Të Hyrat nga Konsumatorët e Privilegjuar | | | | 0 | 0,0 |
| 11 | Shpenzimet e Borxhit të Keq | | | | 5.000,0 | 5.000,0 |
| 12 | Të Hyrat tjera Operative | -1.500,0 | 0,0 | | | -1.500,0 |
| 13 | Eksporti | | | | -4.466,6 | -4.466,6 |
| 14 | Shpenzimet e HQ | 5.361,5 | 2.654,3 | 1.790,7 | 2.014,5 | 11.821,0 |
| 15 | Azhustimet per CapEx te pa realizuar per 2010 | -1.496,3 | -1.103,0 | -1.633,9 | -3,1 | -4.236,2 |
| 16 | Shuma Totale e Të Hyrave të Lejuara | 75.660,5 | 48.467,1 | 21.321,5 | 52.247,3 | 197.696,37 |

Shënim: Rritja e propozuar në tantiemen e linjtit nuk është e përfshirë në tarifat e shitjes me pakicë.

6. Tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes

Në letrën e datës 30 Dhjetor 2010 dërguar KEK-ut, ZRrE-ja e ka dhënë udhëzimin në vijim:

Duke marrë parasysh transaksionin e KEDS-it, sipas Ligjeve të reja, mundësinë për kalimin e të gjithë konsumatorëve jo-shtëpiak në kategorinë e konsumatorëve të kualifikuar, tarifat e furnizimit me shumicë të energjisë elektrike, tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes sidhe tarifat e rregulluara me pakicë duhet të vendosen ndaras. Të licencuarit duhet të sigurojnë që aplikacionet e tyre të përmbajnë propozime përkatëse për secilinë kategori të tarifave dhe të ngarkesave.

Tarifat për shërbimin me energjinë elektrike me pakicë në Kosovë, tradicionalisht kanë qenë të lidhura duke përfshirë kostot për Energjinë elektrike me shumicë, Transmisionin, Shpërndarjen, dhe Furnizimin me pakicë. Pasi që tarifat po shturen, kostot e shpërndarjes duhet të ndahen. Brenda kategorisë së konsumatorëve të shpërndarjes, dëshirohet të alokohen kostot sipas niveleve të tensionit në të cilin shërbehen konsumatorët dhe të zhvillohen tarifa për të mbuluar kostot e shpërndarjes për konsumatorët e kyçur në 35 kV, 10 kV, dhe 0.4 kV. Kjo jep një transparencë në caktimin e çmimit sipas niveleve të tensionit dhe do të përdoret si njëra nga komponentët e tarifave të shthurura në caktimin e tarifave me pakicë. Përveç kësaj, kjo mund të përdoret për të ngarkuar konsumatorët e privilegjuar për shërbimin e shpërndarjes në rast se ata zgjedhin të shërbehen nga tjetërkush pos KEK-ut, Furnizuesit Publik.

Shtojca C përmban një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë së përdorur për të zhvilluar tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes (DUOS) për shërbimin në 35, 10, dhe 0.4 kV dhe përmban llogaritjen e tarifave duke përdorur Bilancin Energjetikë dhe Të Hyrat e Lejuara të aprovuara nga ZRrE-ja në vendimin e fundit tariforë të bazuar në kostot e vitit 2010. Siç është diskutuar në atë dokument, KEK-u e ka përdorur udhëzuesin e dhënë nga ZRrE-ja në Metodologjinë Tarifore si në vijim:

5.5 Fushëveprimi i metodologjisë

Të Hyrat e Lejuara të OSSh-së i mbulojnë ato kosto që janë të ndërlidhura me dispozitat e sistemit të shpërndarjes në tensionin e mesëm dhe të ulët brenda Kosovës. Kjo përfshinë kostot e:

- ndërtimit të sistemit të shpërndarjes;
- mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes; dhe
- operimin e sistemit të shpërndarjes.

5.7 Humbjet

OSSH-ja do të marrë një lejim të arsyeshëm të humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes.

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Ju lutemi referojuni Shtojcës C për hollësitë e metodologjisë. Për qëllim të këtij aplikacioni, KEK-u e ka përdorur metodologjinë e njëjtë për Bilancin Energjetik 2011 dhe për Të Hyrat e Lejuara të kërkuara në këtë Aplikacion. Ajo analizë e nxori tarifën DUOS në vijim të cilën KEK-u po e kërkon në këtë aplikim:

Tarifat e Përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes për Konsumatorët e kyçur në :

| | |
|--------|-------------------------|
| 35 kV | 1.46 € për kWh faturuar |
| 10 kV | 1.67 € për kWh faturuar |
| 0.4 kV | 2.90 € për kWh faturuar |

Shtojca E përmban llogaritjet e hollësishme dhe materialet mbështetëse.

7. Tarifat e Shturura Bazuar në Të Hyrat e Lejuara

Siç është udhëzuar nga ZRrE-ja në letrën e saj të 30 Dhjetorit 2010, KEK-u i ka zhvilluar tarifatat e shturura bazuar në të Hyrat e Lejuara dhe Bilancin Energjetik për vitin 2011. Në mënyrë që të përputhen me direktivat për shturjen e tarifave, KEK-u i ka përgatitur hollësitë e komponentëve në vijim për shturjen e tarifave me pakicë:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me shumicë
- Shërbimi i Transmisionit
- Tarifatat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes sipas tensionit të furnizimit
- Kosto e Furnizimit me Pakicë

Shtojca D përmban një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë që përdoret për tarifatat e shturura dhe përmban llogaritjet e tarifave duke përdorur Bilancin Energjetik dhe Të Hyrat e Lejuara të aprovuara nga ZRrE-ja në vendimin e fundit tarifor të bazuar në kostot e vitit 2010. Ju lutemi referojuni Shtojcës D për hollësitë e metodologjisë. Për qëllim të këtij aplikimi tarifor, KEK-u e ka aplikuar të njëjtën metodologji si në Bilancin Energjetikë 2011 dhe të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 të kërkuara në këtë aplikacion. Metodologjia mund të përmbledhet në hapat në vijim:

1. Pikënisja e Të Hyrave të Lejuara të kërkuara për vitin 2011 për:

Mihje
Gjenerim
Rrjet
Furnizim

Siç mund ta shohë lexuesi në “Përmbledhjen e Të Hyrave të Lejuara” në Seksionin 5, kostot janë shturur në një masë të konsiderueshme.

2. Rregullimet janë bërë për:

Energjinë e përdorur nga mihjet

Shitjet e energjisë për humbjet teknike për Furnizim në OSSH

Shitjet e energjisë për humbjet komerciale për Furnizim në OSSH

3. Përcaktimi i çmimit për transferimin e thëngjillit nga mihjet në gjenerim
4. Zhvillimi i një çmimi të shitjes së energjisë elektrike me shumicë (Gjenerimi KEK-ut, importet, dhe blerjet nga hidrocentralet)
5. Përdorimi i tarifës DUOS siç është diskutuar në seksionin 6
6. Alokimi i pagesës së transmisionit për secilin nivel të tensionit të shitjes me pakicë
7. Përcaktimi i kostove të Furnizimit dhe alokimi në nivelin e tensionit të shitjes me pakicë

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

8. Përcaktimi se në cilën kategori tarifore për konsumatorët me pakicë të alokohet subvencioni i importit. Ishte vendosur që subvencioni të alokohen vetëm te konsumatorët e Amvisërisë.

Shtojca F përmban një përshkrim të thellë të metodologjisë që është përdorur për të zhvilluar tarifat e shturura dhe për t'i alokuar ato te të gjithë konsumatorët e rregulluar që shërbehen në 220, 110, 35, 10, dhe 0.4 kV, duke përdorur Bilancin Energjetik dhe Të Hyrat e Lejuara të kërkuara për vitin 2011.

Në vijim është një përmbledhje e tarifave të shturura në bazë të nivelit të tensionit

Përmbledhje e Tarifave të Shturura

| | 220kV | 110 kV | 35 kV | 10 kV | 0.4 kV | TOTALI |
|---|--------------|---------------|--------------|--------------|---------------|----------------|
| MWH e Faturuar | 678,279 | 89,500 | 33,901 | 191,636 | 2,487,700 | 3,481,016 |
| Çmimi në Euro Cent për kWh | | | | | | |
| Kosto e Energjisë | 3.40 | 3.40 | 3.40 | 3.40 | 3.40 | |
| Kosto e Transmisionit | 0.15 | 0.28 | 0.35 | 0.40 | 0.53 | |
| Pagesa DUOS | 0.00 | 0.00 | 1.46 | 1.67 | 2.90 | |
| Pagesat e Furnizimit : | 0.00 | 0.00 | 0.05 | 0.06 | 0.93 | |
| Subvencioni i Importit | | | | | (1.41) | |
| Çmimi total për nivel të tensionit | 3.55 | 3.68 | 5.25 | 5.53 | 6.34 | 5.68 |
| Çmimi pa subvencion | 3.55 | 3.68 | 5.25 | 5.53 | 7.75 | |
| Të Hyrat në Mijra Euro | 24,071 | 3,291 | 1,781 | 10,595 | 157,828 | 197,566 |

Siç tregon tabela më lartë, tarifat e shturura i mbulojnë të Hyrat e Lejuara prej €197 milion, kur aplikohen në shitjet nga Bilanci Energjetikë. Ju lutemi referojuni Shtojcës F për prejardhjen e tarifave më lartë. Tarifa 0.4 kV është shturur edhe më tutje për secilën nga klasat e konsumatorëve (komercial të mëdhenjë, komercial të vegjël, ndriçimit publikë dhe amvisërisë) për faktin se subvencioni për importin e energjisë elektrike është alokuar vetëm në klasën e Amvisërisë. Kjo informatë është përdorur në zhvillimin e tarifave kosto-reflektuese të diskutuara në Seksionin 8.

8. Zhvillimi i Tarifave Kosto-Reflektuese

Tarifat kosto-reflektuese për secilën klasë tarifore të shitjes me pakicë janë përcaktuar duke i përdorur komponentët e tarifës së shthurur në Seksionin 7 për të arritur te çmimi kosto-reflektues:

- Çmimi i shitjes me shumicë të energjisë elektrike
- Shërbimi i Transmisionit
- Tarifat për Përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes sipas nivelit të tensionit
- Kostot e Furnizimit me Pakicë

Këto tarifa kosto-reflektuese krahasohen me tarifat aktuale mesatare për secilën klasë tarifore të shitjes me pakicë për të përcaktuar se deri në ç' masë tarifat aktuale janë duke i mbuluar kostot për të kryer shërbimin. Tabela në vijim paraqet tarifën kosto-reflektive (në € për kWh) ndaj tarifës mesatare aktuale sipas nivelit të tensionit. Kjo tregon se tarifat e tanishme 220, 110, 35, dhe 10 kV mbulojnë më shumë se kostoja (për 15 deri 20%) derisa tarifat 0.4 kV në përgjithësi mbulojnë vetëm 87% të koston. Kur aplikohen në shitjet e parashikuara në Bilancin Energjetikë, mund të caktojmë shumat e koston në Euro për shërbim në krahasim me të hyrat e parashikuara siç paraqiten në fund të tabelës.

| Krahasimi i tarifave Kosto-Reflektuese me tarifat aktuale sipas nivelit të tensionit: | | | | | | |
|--|---------------|---------------|--------------|--------------|---------------|--------------|
| | 220 kV | 110 kV | 35 kV | 10 kV | 0.4 kV | Total |
| Kosto-reflektuese | 3.55 | 3.68 | 5.25 | 5.53 | 6.34 | 5.68 |
| Tarifat e Tanishme Mesatre | 4.16 | 4.21 | 6.20 | 6.62 | 5.54 | 5.30 |
| Aktuale si % të Kosto-refelktuese | 117% | 115% | 118% | 120% | 87% | 93% |
| MWh e faturuar | 678,279 | 89,500 | 33,901 | 191,636 | 2,487,700 | 3,481,016 |
| Të Hyrat sipas Tarifave Kos-refl | 24,071 | 3,291 | 1,781 | 10,595 | 157,828 | 197,566 |
| Të hyrat sipas tarifave aktuale | 28,216 | 3,768 | 2,102 | 12,686 | 137,819 | 184,591 |
| Ndryshimi | 4,145 | 477 | 320 | 2,091 | (20,009) | (12,975) |
| | 17% | 15% | 18% | 20% | -13% | -7% |

Është bërë edhe një analizë tjetër për klasat e ndryshme tarifor të shërbimit në 0.4 kV. Siç paraqiten në tabelën më poshtë, konsumatorët e Mëdhenj Komercial paguajnë pjesërisht koston, derisa konsumatorët e Vegjël Komercial dhe Ndriçimi Publikë paguajnë 11 deri 13% mbi kosto. Klasa e Amvisnisë, që konsumon 55% të energjisë paguajnë vetëm 80% të koston së shërbimit. Kjo është përkundër faktit se i tërë subvencioni i Qeverisë për energjinë e importuar (€35 milion) është alokuar te ata. Ata akoma janë €23 milion mangut për ta mbuluar koston e tyre.

| Krahasimi i tarifave Kosto-reflektuese për klasat e konsumatorëve në 0.4 kV : | | | | | |
|--|--------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------|
| | Komercial Të mëdhej | Komercia Të vegjël | Ndriçimi Publikë | Tërë Amvisnia | TOTALI |
| Kosto-reflektuese | 7.75 | 7.75 | 7.75 | 5.93 | 6.34 |
| Tarifat e Tanishme Mesatre | 7.41 | 8.75 | 8.62 | 4.72 | 5.54 |
| Aktuale si % të Kosto-refelktuese | 96% | 113% | 111% | 80% | 87% |
| MWH e faturuar | 196,185 | 361,303 | 10,100 | 1,920,112 | 2,487,700 |
| Të Hyrat sipas Tarifave Kos-refl | 15,207 | 28,005 | 783 | 113,832 | 157,828 |
| Të hyrat sipas tarifave aktuale | 14,537 | 31,614 | 871 | 90,629 | 137,651 |
| Ndryshimi | (669) | 3,609 | 88 | (23,203) | (20,176) |
| | -4% | 13% | 11% | -20% | -13% |

8.1. Rregullimi i Rekomanduar për Secilën Klasë Tarifore

Bazuar në Të Hyrat e Lejuara të rekomanduara prej €197.7 milion dhe të hyrat e pritura prej €184.5 milion, kërkohet një ngritje prej 7.1% (€13.2 milion).

Siç është rekomanduar në vitet e mëparshme, qasja që është përdorur për të alokuar rritjen ishte shqyrtimi i mundësisë që secila tarifë ta mbuloj koston e shërbimit siç është diskutuar më lartë, të gjitha tarifat të lëvizin më afër koston. Pasi që tarifa 220 kV vetëm sa është zhvilluar, nuk propozohet asnjë rregullim për të. Të gjitha klasat tjera tarifore janë alokuar fillimisht me një ngritje 4% më ulët sesa ngritja e përgjithshme prej 7.1%, në mënyrë që ato të bartin diçka nga koston. Klasa e Madhe Komerciale është alokuar me një ngritje shtesë pasi që është pjesërisht më ulët se kostoja.

Tarifat e amvisnisë janë rritur me shuma shtesë pasi që ato janë shumë më ulët se kostoja. Qëllimi është që ato gradualisht të jenë më afër koston. KEK-u rekomandon që klasa e Amvisnisë me anë të përdorimit të ndërruesve tariforë (klasa më e madhe nga të gjitha) të rritet me 11%, ndërsa klasa e konsumatorëve pa ndërrim tariforë dhe konsumatorëve të pamatur (paushallë) të ketë një rritje prej 16%. Këto Rritje të propozuara për amvisërinë do i lëvizin ata nga 80% në 88% të koston së shërbimit.

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

| Kategoria | Faturimi me | 4.0% | Rritje | Të Hyrat e | |
|------------------------|------------------------|-----------------------------------|------------------------|-----------------------|------------------------|
| <u>Tarifore</u> | Tarifat e 2010 | Rritje | Shtesë | Propozuara | Rritja |
| | <u>Totali €</u> | <u>Të Gjitha Kategorit</u> | <u>Totali €</u> | <u>Total €</u> | <u>Totale %</u> |
| 220kV | 28,228,031 | 28,228,031 | 0 | 28,228,031 | 0.00% |
| 110 kV | 3,763,900 | 3,914,456 | 0 | 3,914,456 | 4.00% |
| 35 kV | 2,100,260 | 2,184,270 | 0 | 2,184,270 | 4.00% |
| 10 kV | 12,682,867 | 13,190,181 | 0 | 13,190,181 | 4.00% |
| Kons.e Mëdhënjë | 14,542,968 | 15,124,687 | 138,115 | 15,262,802 | 4.95% |
| Kons. e Vegjël | 31,605,504 | 32,869,724 | 0 | 32,869,724 | 4.00% |
| Amv. - KD | 81,525,238 | 84,786,248 | 5,706,767 | 90,493,014 | 11.00% |
| Amv. – Pa KD | 7,591,099 | 7,894,743 | 910,932 | 8,805,675 | 16.00% |
| Amv. Pa Matje | 1,588,142 | 1,651,668 | 190,577 | 1,842,245 | 16.00% |
| Ndriçimi | 871,123 | 905,968 | 0 | 905,968 | 4.00% |
| Totali | 184,499,132 | 190,749,976 | | 197,696,366 | 7.15% |

9. Dizajni Tariforë

KEK-u nuk është duke propozuar ndryshime në Strukturën Tarifore përveç lëvizjes drejt tarifave kosto-reflektuese për klasat e Amvisërisë të diskutuara më lartë. Siç është diskutuar në shqyrtimet e mëparshme tariforë, KEK-u beson se nuk ka modifikime tjera të cilat ZRrE-ja duhet ti marrë në konsideratë, duke përfshirë:

- Eliminimin e strukturës tarifore të kohës së përdorimit ditorë për konsumatorët e Amvisërisë dhe ata të vegjël komercial pasi që ndërruesit tariforë për ata konsumatorë nuk kanë mbështetjen e baterive adekuate për të mbuluar kohën e ndërprerjes së energjisë elektrike. Po ashtu ato klasa kanë një mundësi të kufizuar për ta bartur ngarkesën në periudhat jashtë pikut në mënyrë që ta arsyetojnë tarifën si një mjetë të menagjimit të kapacitetit.
- Ndryshimi Verë / Dimër për të gjitha klasat tarifore nuk është kosto reflektuese. Për shumicën e klasave, tarifat verore janë nën koston e gjenerimit. Po ashtu, pasi që shumica e kostove për mihje dhe gjenerim janë fikse, ndryshimi i madh nuk mundëson që të hyrat ti përcjellin kostot.
- Blloku i parë i tarifave të amvisërisë është caktuar shumë më ulët se kostoja sipas praktikës së ZRrE-së në përpjekje për të ndihmuar konsumatorët me të ardhura të ulëta. Natyrisht, ky lloj subvencioni nuk është i përcaktuar mirë pasi që nga ai përfitojnë të gjithë konsumatorët. Subvencioni i Qeverisë për Rastet Sociale është i rregulluar mirë dhe është një mënyrë shumë më efikase. ZRrE-ja inkurajohet që të punojë me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për të zgjeruar numrin e pranuesve të këtij subvencioni për të gjithë amvisërinë në varfëri të skajshme, siç i ka propozuar KEK-u Ministrisë.

Pritet që tarifat e propozuara së bashku me çmimet e përditësuara, të hynë në fuqi me 1 Prill 2011.

Orari i propozuar i tarifave është përfshirë në Tabelën Nr. 1 së bashku me krahasimin e tarifave ekzistuese.

Tabela Nr. 2 e paraqet çmimin mesatarë për kWh për secilën klasë tarifore bazuar në tarifat e tanishme dhe tarifat e propozuara.

10. Përmbledhje

Mbledhja e të dhënave, elaborimi dhe kompletimi i këti Aplikimi Tariforë u përfundua si rezultat i analizave të thella të nevojave të bilancit energjetikë; alokimit të strukturës së kostos, alokimit të kostos në klasat tarifore dhe tarifat strukturale individuale.

Tabela në vijim përmbledhë aktivitetet gjatë konsultimit mes dy palëve (KEK-ut dhe ZRrE-së).

| Nr. | Përshkrimi i konsultimeve | Data |
|------------|--|-----------------|
| 1. | ZRrE fton KEK-un në takim për datën 26.05.2010, lidhur me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullativ | 24 Maj 2010 |
| 2. | ZRrE i dërgon KEK-ut minutat e takimit të datës 26.05.2010 | 27 Maj 2010 |
| 3. | ZRrE fton KEK-un në takim konsultativ për datën 21.07.2010, lidhur me llogarit rregullatore bazuar në analizat e bilancit testues, pasqyrat financiare dhe llogaritë e shthurura | 19 Korrik 2010 |
| 4. | KEK-u i dërgon ZRrE-së komentet lidhur me ngritjen e çmimit të tantiemes për linjit | 5 Tetor 2010 |
| 5. | ZRrE i dërgon KEK-ut komente lidhur me rritjen e tantiemes për linjit | 6 Tetor 2010 |
| 6. | KEK-u i dërgon ZRrE-së Aplokimin për rregullim tarifot lidhur me çmimin e tantiemes të linjtit të vendosur nga KPMM | 13 Tetor 2010 |
| 7. | ZRrE kërkon nga KEK-u regjistrin e asetëve për vitin 2008. | 13 Nëntor 2010 |
| 8. | ZRrE dorëzon verzionin e fundit të Modelit për Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullativ | 29 Nëntor 2010 |
| 9. | KEK – ZRrE; KEK-u dërgon kërkesën për krijimin e tarifës së rregulluar për shërbimet në nivelin 220kV | 6 Dhjetor 2010 |
| 10. | KEK-u i dorëzon ZRrE-së Modelin e Raportimit të Kontabilitetit Rregullativ në CD, të plotësuar me të dhënat financiare të audituara për vitin 2009. | 14 Dhjetor 2010 |
| 11. | ZRrE i dërgon KEK-ut proces verbalin e takimit të 15.12.2010, lidhur me aplikimin për krijimin e tarifës së rregulluar për shërbime në nivelin e tensionit 220kV | 23 Dhjetor 2010 |
| 12. | KEK-u i dërgon ZRrE-së komente lidhur me proces verbalin e takimit të datës 15.12.2010. | 24 Dhjetor 2010 |
| 13. | ZRrE i dërgon KEK-ut njoftimin lidhur me Shqyrtimin e pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE5 2011. | 30 Dhjetor 2010 |
| 14. | ZRrE i dërgon KEK-ut formularët për Aplikimin Tarifor 2011 për SHTE5 | 6 Janar 2011 |
| 15. | KEK-u i dërgon ZRrE-së Aplikacionin Tarifor për SHTE5 së bashku me , Modelin e KEK sh. A., formularët e plotësuar të ZRrE-së dhe Apendiksin C dhe E për Rrjet(DUOS). | 28 Janar 2011 |

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Tabela Nr. 1 Tarifat Ekzistuese dhe Të Propozuara

Shënim: Rritja e rekomanduar prej 0.54 €c për kWh për taniemën e linjtit NUK është e përfshirë në çmimet e më sipërme.

| Tarifat e Energjisë Elektrike 2011 | | | | | | 2010 | | 2011 | |
|------------------------------------|---|--|-------------------|-------------------|--------------------|----------------------|--------------------|----------------------|------|
| Grupi Tarifor | Niveli i Tensionit të Furnizimit | Elementet Tarifore | Njësia | Koha e Përdorimit | Tarifat Eksistuese | | Propozuar - KEK | | |
| | | | | | Sezoni i Lartë | Sezoni i Ulët | Sezoni i Lartë | Sezoni i Ulët | |
| | | | | | 1 Tetorë - 31 Mars | 1 Prill - 30 Shtator | 1 Tetorë - 31 Mars | 1 Prill - 30 Shtator | |
| - | 220kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | | | 1,000.00 | | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | | | 13.00 | 13.00 | |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | | 2.09 | 2.09 | |
| | | Energjia Reaktive | €/kWh | Tarifa e Ultë | | | 2.09 | 2.09 | |
| | | | €/kVArh | | | | 0.00 | 0.00 | |
| 0 | 110kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 83.83 | | 87.00 | | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 559.00 | 559.00 | 580.00 | 580.00 | |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 6.49 | 1.92 | 6.74 | 1.99 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 2.70 | 1.58 | 2.81 | 1.67 |
| | | | €/kVArh | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | |
| 1 | 35kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 11.08 | | 11.50 | | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 581.00 | 581.00 | 600.00 | 600.00 | |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 6.79 | 2.94 | 7.05 | 3.08 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 3.59 | 2.65 | 3.73 | 2.77 |
| | | | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | 0.69 | 0.69 | |
| 2 | 10kV | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 4.58 | | 5.00 | | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 501.00 | 501.00 | 520.00 | 520.00 | |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 7.61 | 3.39 | 7.90 | 3.54 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 4.10 | 3.09 | 4.27 | 3.22 |
| | | | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | 0.69 | 0.69 | |
| 3 | 0.4kV Kategoria I (Konsumatorët e mëdha me Energji Reaktive | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.58 | | 2.80 | | |
| | | Ngarkesa Fikse (Fuqisë) | €/kW | | 291.00 | 291.00 | 300.00 | 300.00 | |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 8.45 | 4.69 | 8.85 | 4.95 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 5.33 | 4.43 | 5.69 | 4.67 |
| | | | €/kVArh | | 0.66 | 0.66 | 0.69 | 0.69 | |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.92 | | 3.00 | | |
| | | Active energy (P) | €/kWh | Një Tarifor | | 10.41 | 6.73 | 10.86 | 7.00 |
| | | Energjia Aktive (P) | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 12.53 | 8.21 | 13.02 | 8.55 |
| | | | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 6.26 | 4.10 | 6.52 | 4.28 |
| 5 | 0.4kV (Shtëpiak, 2-Tarifor) | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.08 | | 2.30 | | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: <200kWh/month (First Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 4.64 | 3.33 | 5.15 | 3.72 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: <200kWh/month (First Block): | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 2.33 | 1.66 | 2.59 | 1.85 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: 200-600 kWh/month (Second Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 6.43 | 4.60 | 7.14 | 5.11 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: 200-600 kWh/month (Second Block): | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 3.22 | 2.31 | 3.57 | 2.56 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: >600 kWh/month (Third Block): | €/kWh | Tarifa e Lartë | | 9.33 | 6.68 | 10.36 | 7.42 |
| | | | €/kWh | Tarifa e Ultë | | 4.66 | 3.35 | 5.16 | 3.72 |
| 6 | 0.4kV (Shtëpiak, 1-Tarifor) | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.08 | | 2.30 | | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: <200kWh/month (First Block): | €/kWh | Një Tarifor | | 4.14 | 2.96 | 4.88 | 3.46 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: 200-600 kWh/month (Second Block): | €/kWh | Një Tarifor | | 5.73 | 4.10 | 6.69 | 4.78 |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: >600 kWh/month (Third Block): | €/kWh | Një Tarifor | | 8.31 | 5.96 | 9.71 | 6.95 |
| 7 | 0.4kV (Shtëpiak i Pa-matur) | Konsumi i përafërt <200kWh/muaj | €/customer/month | | 21.50 | | 25.30 | | |
| | | Konsumi i përafërt 200-600kWh/muaj | €/customer/month | | 38.92 | | 44.10 | | |
| | | Konsumi i përafërt >600kWh/muaj | €/customer/month | | 65.58 | | 79.70 | | |
| 8 | Ndriqimi Publik | Ngarkesa Fikse (e Konsumatorit) | €/Konsumator/Muaj | | 2.92 | | 3.00 | | |
| | | Energjia Aktive (P), për konsum: | €/kWh | Një Tarifor | | 8.42 | 8.42 | 8.76 | 8.76 |

Sezona e Lartë - Dimërore fillon më : 1 Tetor deri 31 Mars, ndërsa Sezona e Ulët - Verore: 1 Prill deri 31 Shtator

Koha e Përdorimit: Tarifa e Lartë - Aplikohet nga ora 07:00-22:00 gjatë Sezonit të Lartë-Dimëror, dhe nga ora 08:00-23:00 gjatë sezonit të Ultë-Veror

Ngarkesa me Energji Reaktive është për gjithë Energjinë Reaktive të tej-masës të $\cos \varphi = 0,95$

Tabela Nr. 2, Tarifat Mesatare sipas Grupeve – Të Propozuara në Krahasim me Aktualet

Tarifat Mesatare të KEK-ut

(Të shprehura në € për kWh të faturuar)

Bazuar në: Parashikimin e Shitjeve për vitin 2011
Përcaktuesit e Faturimit për vitin 2011
Tarifat Aktuale të Aprovuara nga ZRrE në fuqi që nga 01 Prilli
2009

Tarifat e propozuara nga KEK-u në fuqi nga 01 Prilli 2011
Pa Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

| Kodet: ERO-KEK | Klasa tarifore | Çmimi Mesatarë (cent/kWh) | |
|-------------------|--|---------------------------|------------|
| | | Aktuale | Propozuara |
| - | 220 KV | 4.16 | 4.16 |
| 0 - 1/1 | 110 KV | 4.21 | 4.37 |
| 1- 1/2 | 35 KV | 6.20 | 6.44 |
| 2- 1/3 | 10 KV | 6.62 | 6.88 |
| 3 -6/6 | Të Mëdhenj Komercial | 7.41 | 7.78 |
| 4 -7/2 | Të Vegjël Komercial (Koha e Përdorimit Ditorë) | 8.21 | 8.86 |
| 4 -7/1 | Të Vegjël Komercial (pa KPD) | 10.02 | 10.50 |
| 5 -4/2 | Amvisni (Koha e Përdorimit) | 4.66 | 5.17 |
| 6 - 4/1 | Amvisni (pa KPD) | 5.41 | 6.27 |
| 7- 9/1,2,3 | Amvisni (pa KPD) | 5.35 | 6.20 |
| 8 - 8/1 | Ndriçimi Publikë | 8.62 | 8.97 |
| | AMESATARE – TË GJITHË KONSUMATORËT E RREGULLUAR | 5.30 | 5.68 |

Shënim: Tarifat mesatare ndryshojnë në bazë të strukturë së përdorimit të konsumatorëve individual (sezonale dhe tarifa kohës së përdorimit ditorë) dhe për konsumatorët e mëdhenj në bazë të konsumit të tyre në raport me faturimin (faktori i ngarkesës). Këto më lartë janë mesataret për klasat përkatëse .

Rritja e rekomanduar prej 0.54 € për kWh për tantimën e linjtit NUK është e përfshirë në çmimet e më sipërme.